



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Puniljena / Prodatur / Received / Delivered	30.05.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. / Unit	Hi / Pret / Hi / Pret / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicitina / Quantity
SKUMSHOCK	3152 / 2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.378/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.378/2022 të datës 14.04.2022, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. DETYROHET Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesja brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- II. OBLIGOHET Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 14.04.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër mos nxjerrje së vendimit nga Komisioni për Grada dhe Disipline, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.04.2022, ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë 29.04.2022 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka dërguara përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 2119/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 07.03.2022, për qasje në dokumente zyrtarë; Vendimi i datës 15.03.2022, i z, v Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës e- maili i datës 17.03.2022; E- maili i datës 31.03.2022, drejtuar anëtarëve të Komisionit për Gradim; Kërkesë e datës 07.09.2022, drejtuar Komisionit për Grada dhe Disiplinë; Vendimi i datës 10.09.2018, i Zëvendëskryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 30.12.2015, i Zëvendëskryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Formuari për Vlerësimin e nëpunësit për Shërbime të Jashtme; i vitit 2020; Vërtetim i datës 06.09.2021; Vendimi i datës 22.07.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 23.09.2019, për caktimin e ushtrueses së detyrës; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit të datës 10.06.2013; Akt Emërimi i datës 20.07.2012; Vendimi i datës 15.03.2022, i Z v Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vërtetim i datës 06.09.2021, i Udhëheqësit të Divizionit të Personelit; Përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022, me numër protokollit 2533/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht Komisionin për Grada dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative në pajtim me kompetencat ligjore që ka, për të vendosur lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesi drejtuar Komisionit për Grada dhe Disiplinë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kërkesë e cila ishte parashtruar pas njoftimit nga ana e Zyrës së Sekretarit të MPJD-së e datës 03.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisionin për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me parashtrimin e kërkesës së ankueses të datës 07.09.2021 ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"* në pajtim me mandatin ligjor që ka duke iu referuar Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës neni 30 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ku përcaktohet se: *"Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm"* në mbështetje edhe të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullosës Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: *"Gradimi në pozita më të larta dhe rritja në baza të meritave do të shqyrtohet nga Komisioni"* ndërlidhur me nenin 12 paragrafit 2 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlefshmërinë e caktimit të*



gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore”.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstatuar se pas pranimit të Vendimit të KPMSHCK-së, organi i punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës respektivisht Komisioni për Grada dhe Disiplinë, duhet të shqyrtojë kërkesën dhe të veproje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji nr. 03/1-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, pasi që na bazë të procesverbalit të datës 02.12.2021 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të cilin ankuesja pas kërkesës për qasje në dokumente publike ka arritur ta ketë në posedim me datë 17.03.2022, të njëjtët nuk ka vendos sipas obligimeve ligjore që kanë duke nxjerr akt administrativ përmes të cilit i pranohet apo i refuzohet kërkesë për avancim.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 378/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

